



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Jashtme, Diasporë dhe Investime Strategjike
Mbledhja nr. 10
Prishtinë, më 31.1.2018, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala S-1

P r o c e s v e r b a l

Në mbledhje morën pjesë: Vjosa Osmani-Sadriu, Aida Dërguti, Visar Ymeri, Elmi Reçica dhe Evgjëni Thaçi-Dragusha.

Munguan: Time Kadrijaj, Danush Ademi, Dukagjin Gorani, Doruntinë Maloku-Kastrati, Sërgjan Mitrovic dhe Zafir Berisha.

Në mbledhje ishte i pranishëm për raportim, Behgjet Pacolli, zëvendëskryeministër dhe ministër i MPJ-së, me bashkëpunëtorët: Artan Duraku, Fitim Sadiku, Florent Muçaj, Muhamet Brajshori, Rejhan Vuniqi, Mentor Nezalo, Florent Muçaj, Petrit Makolli dhe Jetlir Zyberaj.

Pjesëmarrësit e tjerë: Artan Murati-KDI; Egnesa Vitia-praktikante, Naim Jakaj-VV dhe media.

Nga stafi i Komisionit: Minire Hasani dhe Manush Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Vjosa Osmani-Sadriu, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Raportimi i z. Behgjet Pacolli, zëvendëskryeministër dhe ministër i Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Vjosa Osmani-Sadriu, theksoi se ministri Behgjet Pacolli, është ftuar që ta njoftojë Komisionin në lidhje me gjendjen në Shërbimin e Jashtëm të Republikës së Kosovës, se në çfarë gjendje e ka gjetur atë, se çfarë shkeljesh mendon se janë bërë aty, se a është duke u bërë ndonjë analizë e rezultateve të deritanishme dhe se cilat janë lëvizjet që mund të priten, në mënyrë që të kemi një shërbim të jashtëm më efektiv. Po ashtu, Osmani tha se ministri është ftuar që të njoftojë edhe për çështjet e njohjeve sepse është duke u zhvilluar një fushatë nga ana e Serbisë në raport me shtetet konkrete, që t'i bindin ato për tërheqjen e njohjeve të Republikës së Kosovës.

Behgjet Pacolli, zëvendëskryeministër dhe ministër i Punëve të Jashtme, ndër të tjera tha se pos angazhimeve të përditshme diplomatike, përballen edhe me sfidat nga Serbia në politikën e jashtme, e

kryesisht në rrugëtimin e Kosovës rreth integriteteve, bashkëpunimit me shtetet tjera e po ashtu edhe me lobimin tek shtetet që e kanë njohur Kosovën, që ato t'i tërheqin njohjet. Në këtë drejtim, tha se Serbia ka siguruar një buxhet prej 300 milionë euro dhe një ekip prej 20 ekspertësh që të vizitojnë shtetet e ndryshme të botës dhe ministrinë e jashtme për të lobuar kundër Kosovës.

Z. Pacolli theksoi se është i gatshëm të raportojë në komision sa herë që parashtrohet nevoja, por se ka shumë angazhime dhe takime jashtë vendit, për të cilat edhe i njoftoi anëtarët e komisionit. Gjithashtu njoftoi se ka arritur njohja nga shteti i Madagaskarit.

Në lidhje me tërheqjen e njohjes nga Guinea Bisao, tha se e ka pasur një fushatë lobimi në këtë drejtim dhe më pas ka ardhur nota verbale, se ajo vazhdon ta njeh pavarësinë e Kosovës. Ai njoftoi se, as Egjipti nuk e ka ndryshuar qëndrim ndaj Kosovës. Sa i përket Surinamit, z. Pacolli tha se jemi duke punuar dhe se pritet të kemi një përgjigje nga Surinami, në favor të Kosovës.

Në lidhje me aktivitetet në MPJ-së dhe temat të cilat do të diskutohen në këtë takim z. Pacolli, tha se ka sjellë për anëtarët e Komisionit një raport me shkrim, kurse sa i përket gradimeve në shërbimin e jashtëm, tha se është duke punuar një komision, për t'i shqyrtuar disa gradime, të cilat kanë ndodhë me rastin e ndërrimit të qeverisë. Ky komision tha se është duke punuar në mënyrë neutrale dhe rezultatet e punës së tij do të merren në konsideratë.

Pacolli po ashtu, njoftoi edhe për komisionin i cili është duke punuar në reformat e MPJ-së, për planin e zgjerimit të rrjetit diplomatik dhe se janë në proces të hapjes së ambasadës në Emirate dhe në Tajlandë.

Ndërsa, në lidhje me anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës, njoftoi se në MPJ është formuar një komision me pjesëtarë edhe të shoqërisë civile, ku në të ardhmen do të ketë edhe anëtarë të miqve tanë, i cili është duke punuar dhe ka për detyrë që në tre muajt e ardhshëm të njoftojë për vështirësitë të cilat mund t'i kemi me rastin e aplikimit për anëtarësim, tani apo më vonë.

Pacolli potencoi rëndësinë e bashkëpunimit me Komisionin e Venedikut dhe sfidat e Kosovës rreth procesit të demarkacionit dhe Gjykatës Speciale.

Vjosa Osmani-Sadriu, duke u ndërlidhur me raportimin e ministrit, bëri disa komente mes të cilave ritheksoi interesimin e komisionit që të jetë pjesë e grupeve punuese apo task forcave që formohen lidhur me organizatat ndërkombëtare e në veçanti Këshillin e Evropës. Ajo pyeti se mungesa e emërimit të shefave të misionit apo ambasadorëve në Tiranë, Pragë, Stokholm, a jep mesazh negativ në këto shtete dhe se për çfarë arsye është tërheqë propozimi i kandidatit për ambasador në Çeki, pas përfundimit të procedurës së dëgjimit. Osmani pyeti edhe në lidhje me tejkalimin e kuotës prej 50% të të emëruarve politikë, dhe cili është numri i përgjithshëm i të emëruarve politikë në pozita udhëheqëse në misionet diplomatike, në cilat shtete dhe se si do të adresohet ky tejkalim.

Znj. Osmani pyeti ministrin edhe për fushëveprimtarinë e zëvendësministrave dhe për takimet me ta.

Visar Ymeri, tha se në Konferencën Atlantic Council, ministri Pacolli në një përballje me ministrin e MPJ-së së Serbisë, në njëfarë mënyre ka bërë ftesë që veriun e Kosovës ta bëjnë zonë të lirë ekonomike. Kjo tha se, nënkupton që Republika e Kosovës konsideron që sovranitetin e vet në përjetësi do ta shtrijë vetëm deri tek lumi Ibër, ndërsa sa i përket veriut të bëjnë marrëveshje me Serbinë, që sipas kësaj deklarate nënkupton të kemi sovranitet të përbashkët me Serbinë. Në një intervistë tha se ministri ka deklaruar se nuk njohim blloqe lindje-perëndim dhe se jemi të interesuar për marrëdhënie të mira me Rusinë. Ymeri pyeti se a ka ndryshim të politikës së Qeverisë në këtë drejtim apo është mendim i ministrit të MPJ-së, duke ditur qasjen që ka Rusia ndaj Kosovës. Po ashtu, në lidhje me shprehjet e ministrit se dialogu me Serbinë nuk ka vija të kuqe, Ymeri tha se dialogu i mirëfilltë i Republikës së Kosovës do të duhej të kishte vija të kuqe.

Në vazhdim tha se në një koalicion ku ka parti që kanë pasur dhe vazhdojnë të kenë qëndrime të ndryshme për sa i përket çështjeve të caktuara, duhet së paku të arrihet një modus i qëndrimit të përbashkët për këto çështje, në mënyrë që kjo qeveri të quhet e Republikës së Kosovës.

Ai pyeti ministrin se cili është qëndrimi zyrtar i Qeverisë së Kosovës, sa i përket tregut të përbashkët rajonal si pjesë e Procesit të Berlinit, se çfarë mendon karshi qëndrimit të Spanjës se Kosova nuk është pjesë e planit për zgjerim të BE-së.

Evgjeni Thaçi- Dragusha, duke u ndërlidhur me njoftimin nga ministri se është formuar një grup punues për tu angazhuar për anëtarësim në Këshillin e Evropës, theksoi se zv.kryeministri Enver Hoxhaj, një ditë më parë në komision, tha se do të formohet një task forcë për këtë qëllim. Ajo pyeti se sa ka bashkëpunim brenda Qeverisë për këtë çështje, duke theksuar se një bashkëpunim brenda institucioneve të Kosovës duhet të ekzistojë, përndryshe jemi të interesuar që për këtë çështje të kemi bashkërendim të agjendës me Shqipërinë dhe vendet e rajonit.

Behgjet Pacolli, njoftoi se synimi i MPJ-së është që në shërbimin e jashtëm, stafin politik me atë të karrierës ta barazojnë 50% me 50%. Tash për tash tha se kemi 12 ambasadorë politikë dhe tre konsuj të përgjithshëm, ndërsa 9 ambasadorë të karrierës dhe se pritet që deri në shtator të barazohet kjo përqindje. MPJ është në proces të kthimit të 22 përfaqësuesve diplomatikë, me qëllim që të mos lejohet qëndrimi i tyre më shumë se një mandat jashtë ngase fillojnë të shkëputen nga Kosova. Sa i përket ambasadorit në Tiranë, tha se jemi në proces të bërjes së propozimit, ndërsa sa i përket propozimit për Pragë, njoftoi se nuk e kanë tërheqë propozimin. Propozimi i kandidatit për ambasador në Stokholm, tha se nuk ka kaluar ngase kandidati ka pasur edhe nënshtetësinë e Suedisë.

Pacolli bëri të ditur se e sheh më të arsyeshme që Kosova të ketë ambasador në Poloni ndërsa në Çeki të ketë ambasador jorezident. Ministri Pacolli tha se ka katër zëvendëskryeministra dhe njoftoi për bashkëpunimin me ata dhe fushëveprimtarinë e tyre.

Duke u ndërlidhur me çështjet e ngritura nga deputetët, Pacolli theksoi se e ka shumë të qartë se Kosova e ka shpallë pavarësinë e saj me kufijtë e saj të cilët i njohim duke e përfshirë edhe pjesën veriore të Kosovës. Sa i përket deklaratës me Vuçiqin, tha se të gjithë e dimë se në veri ka forca ilegale dhe se 100% nuk kontrollohet nga institucionet e Kosovës dhe se krijimi i një perspektive ekonomike do të mundësonte shtrirjen e sovranitetit plotësisht atje, por jo të krijohet një zonë e lirë ekonomike atje. Këtë deklaratë pos mediave askush nuk e ka trajtuar si akt që mund ta demantonte Kosovën, duke e ditur se perspektiva ekonomike atje do të krijonte mundësi reale që ata qytetarë ta konsiderojnë veten edhe de facto si qytetarë të Kosovës.

Rreth raporteve me Rusinë, ministri Pacolli tha se Kosova është një vend i vogël dhe se nuk duhet të ketë asnjë paragjykim sa i përket shtrirjes së marrëdhënieve të veta si në lindje, si në jug, veri e perëndim. Sa i përket dialogut, bëri të ditur se ka thënë që dialogu duhet të ketë dy elemente, përbërjen e pjesëmarrësve dhe që bisedimet të limitohen në kohë. Duke ndërlidhur me çështjen e integritetit të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe raportin e Spanjës në lidhje me perspektivën e Kosovës, tha se Kosova duhet t'i përmbushë obligimet që i ka për demarkacionin dhe Gjykatën speciale.

Pacolli tha se është përkrahës i krijimit të tregut rajonal dhe se Kosova duhet të integrohet ekonomikisht në rajon.

MPJ-ja kanë formuar një komision në lidhje me procedurën për anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës, për të cilin tha se është informuar edhe Qeveria, kurtse bëri të ditur se në punën e tij ka bashkëpunim dhe koordinim me faktorët tjerë politikë dhe se raportin edhe tek Presidenti e Kryeministri.

Visar Ymeri, duke u ndërlidhur me njoftimet nga ministri Behgjet Pacolli tha se, nuk e ka të qartë shpjegimin për Atlantic Council dhe formulimet e diplomatëve të Republikës së Kosovës dhe theksoi se është problematike nëse ministri i jashtëm i Kosovës, i bën ftesë ministrit të jashtëm të Serbisë që ta kryejnë një punë bashkë në veri të Kosovës, nëse konsiderojmë njëkohësisht se prania e Serbisë në pjesën veriore të Kosovës është ilegale, do të thotë hyrje në negociata me ilegalitetin. Në diplomaci tha se duhet të kemi parasysh se marrëdhëniet në mes të dy shteteve cilat do qofshin ato ndërtohen në bazë

të interesit të përbashkët, prandaj, duhet të kemi shumë kujdes me ftesat apo qëndrimet e tilla, qofshin edhe individuale, por në këtë rast janë zyrtare.

Rreth deklaratës së ministrit për dialogun, se nuk duhet të ketë vija të kuqe, Ymeri ju referua Dojçe Welles të datës. 5 tetor 2017.

Sa i përket tregut rajonal, Ymeri tha se Kosova duhet t'i zgjedhë vetë partnerët tregtarë, në bazë të potencialit të vet ekonomik dhe interesit të vet dhe se duhet të ekzistojë një treg i unifikuar me Republikën e Shqipërisë.

Vjosa Osmani Sadriu, në lidhje me Procesin e Berlinit, i cili përfshinë edhe çështjen e tregut të përbashkët, tha se është temë për të cilën do të bisedojmë në takimin e radhës ku planifikojmë që të ftojme disa prej ambasadorëve të shteteve, që janë më së shumti të involvuar në këtë proces dhe të shprehin qëndrimin e shteteve të tyre.

Aida Dërguti, duke përmendur praktikën e vendeve skandinave në përfaqësimin e përbashkët diplomatik, dhe duke pasur parasysh se Kosova nuk mund të ketë përfaqësim në çdo vend, pyeti ministrin nëse është planifikuar ndonjë marrëveshje me Shqipërinë, për ndarjen e të njëjtit objekt për përfaqësim diplomatik.

Sa i përket Këshillit të Evropës znj. Dërguti njoftoi ministrin se Kuvendi i Kosovës ka një përfaqësim të akredituar në Këshillin e Evropës dhe se për aplikim të Kosovës duhet të ketë bashkëpunim në mes të Kuvendit dhe MPJ-së. Ajo duke e parë të rëndësishëm përfaqësimin në konsullatën tonë në Strasburg, pyeti për kapacitetin e tyre, duke e vënë në pah se është shumë e rëndësishme që të kemi diplomatë të karrierës ngase komunikimi është më i lehtë.

Elmi Reçica, tha se të gjithë jemi të interesuar që Kosova të përfaqësohet në politikën e jashtme sa më denjësisht dhe sa më fuqishëm. Vendet që nuk janë të fuqishme kanë nevojë që ta kenë një politikë të jashtme shumë të fuqishme dhe të kenë mbështetjen e miqve, të cilëve ju besojnë. Sa i përket dialogut Reçica tha se jemi në fazën e riformimit, do të reagojmë si shtet dhe ne si komision dhe si deputetë do t'ju mbështesim dhe paraprakisht kemi marrë qëndrime, se sovraniteti i shtetit të Kosovës e shumëçka tjetër janë të padiskutueshme.

Në lidhje me disbalancin në shërbimin e jashtëm, tha se ai ekziston, por me nxjerrjen e Ligjit të ri për shërbimin e jashtëm ky disbalanc shpresojmë se do të rregullohet.

Reçica propozoi që komisioni i formuar në lidhje me Këshillin e Evropës, të zgjerohet edhe me përfaqësues nga Presidenca, Kuvendi e zëvendëskryeministrat, për një qëllim të përbashkët.

Behgjet Pacolli, bëri të ditur se MPJ-ja e ka të nënshkruar një memorandum me MPJ-në të Shqipërisë, që të kemi qasje të përbashkët në ato vende ku Shqipëria ka ambasadë, e të cilat vende nuk e kanë njohur Kosovën. Përfaqësi të përbashkëta me Shqipërinë, tha se kemi në Milano, ka filluar hapja e Ambasadës në Kopenhagë, në Munih kemi konsullatë të përbashkët dhe në Stamboll është në proces e sipër të formimit. Bashkëpunimi me Shqipërinë në këtë drejtim, tha se do të vazhdojë dhe se janë në bisedime për dërgimin e dy diplomatëve në Kinë, në ambasadën e Shqipërisë. Ministri theksoi se në Strasburg kemi një përfaqësi dinjitoze dhe se do t'i ketë parasysh propozimet për diplomatë të duhur atje.

Sa i përket diplomacisë ekonomike, Pacolli tha se jemi duke punuar në këtë drejtim, duke pasur parasysh se një diplomat i suksesshëm, i sjell investitorë vendit.

Vjosa Osmani Sadriu pyeti ministrin se sa është numri i diplomatëve të cilët kanë tejkaluar mandatin e tyre 4 vjeçar dhe përtej kësaj vazhdojnë të shërbejnë dhe a hynë ata në grupin prej 22 diplomatëve që planifikohen të kthehen në MPJ. Pyeti ministrin se: a ka anëtarë të shërbimit të jashtëm të cilëve asnjëherë nuk i është dhënë rasti të shërbejnë jashtë, përkundër faktit që punojnë më se 7-8 vite në MPJ

ndërsa të tjerëve ju jepet mundësia pa e përmbushë kohën minimale prej 12 muajve në MPJ që kërkohet me ligj; se a e vlerëson të ligjshëm emërimin e këshilltarit politik në pozitën e të ngarkuarit me punë të përkohshme në Emiratet e Bashkuara Arabe dhe nëse po në cilin nen është bazuar; pse nuk ka ndodhur hapja e zyrave ekonomike në Greqi dhe Izrael që është premtuar se do të hapen më së largu gjerë në janar dhe kur pritet të hapen. Plani i rotacionit dhe i gradimeve për vitin 2018, kryetarja kërkoi që t'i përcillet komisionit në formë të shkruar nëse nuk është konfidencial.

Në vazhdim ajo pyeti se a është respektuar çdo vendim dhe rekomandim i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës sa i përket ankesave për konkurse gradime e çështje të tjera në MPJ dhe se a do të kenë prioritet ato dhe se a ka shefa misionesh që paguhen duke qëndruar në Kosovë dhe nëse është duke ndodhur kjo, a ka bazë ligjore për këtë.

Behgjet Pacolli duke ju përgjigjur pyetjeve të kryetares së komisionit bëri të ditur se lista e diplomatëve të cilëve ju skadon mandati dhe e atyre të cilët do të shkojnë në shërbimin e jashtëm do të jetë e gatshme më 20 shkurt 2018. Sa i përket këshilltarit të tij z. Amir Ahmetit tha se ai nuk është i ngarkuar me punë, por është dërguar në formë delegacioni deri në plotësimin e kushteve për hapjen e ambasadës atje. Ministri njoftoi edhe rreth angazhimeve për hapjen e Zyrës Ekonomike në Greqi, se janë duke punuar në këtë drejtim dhe se presin rezultate. Nga sekretari i MPJ-së anëtarët e komisionit u njoftuan se MPJ-ja është duke i zbatuar vendimet e Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës dhe se nuk ka shef të misionit i cili paguhet duke qëndruar në Kosovë, duke përjashtuar një rast, i cili tha se ka zgjatur deri sa është definuar statusi i saj.

Vjosa Osmani Sadriu falënderoi zëvendëskryeministrin dhe ministrin e Punëve të Jashtme Behgjet Pacolli për raportimin dhe bëri të ditur se në takimin e përbashkët të radhës gjatë muajit shkurt, do të diskutojnë në lidhje me Procesin e Berlinit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetarja Komisionit,

Vjosa Osmani-Sadriu